



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Tel: 038/200 438 14

PLANI STRATEGJIK PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE TË FËMIJËVE ME AFTËSI
TË KUFIZUARA 2025-2027

P R O C E S V E R B A L

Nga dëgjimi publik për Planin Strategjik për Përfshirjen Sociale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara 2025-2027 mbajtur më: **14.08.2025**, në Sallën e Kuvendit Komunal, filluar me punë në ora **11:00**.

Në Dëgjim ishin të pranishëm:

1. Ilir Ferati, Kryetar;
2. Drejtor të drejtorive Komunale;
3. Ardon Arifaj, Zyra e Kryetarit
4. Liliana Frrokaj, Zyra e Kryetarit;
5. Alketa Bujupaj, Zyra e Kryetarit

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i komunës, z. Ilir Ferati dhe Drejtoret e Drejtorive

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Drejtoresha për Mirëqenie Sociale, Merita Muzlijaj

Drejtoresha, z. Merita Muzlijaj - përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje dhe hapi dëgjimin publik për Planin Strategjik për Përfshirjen Sociale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara 2025-2027 dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

R E N D D I T E

1. Njoftimi për Planin Strategjik për Përfshirjen Sociale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara 2025-2027,
2. Pyetje dhe Përgjigje

Konsultimi publik u organizua me qëllim të prezantimit të Planit Strategjik për Përfshirjen Sociale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për periudhën 2025–2027. Në takim morën pjesë përfaqësues institucionalë, organizata joqeveritare dhe prindër.

Takimi u hap nga përfaqësuesi i drejtorisë për mirëqenie sociale, i cili theksoi rëndësinë e këtij plani për ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe të barabartë. U prezantuan objektivat kryesore dhe masat e planifikuara.

Gjatë prezantimit u theksua rëndësia e qasjes në arsim, shërbime shëndetësore, aktivitete sociale dhe mbështetje për familjet. U prezantuan gjithashtu mekanizmat e bashkëpunimit ndër-institucional dhe monitorimit të zbatimit të planit.

Pjesëmarrësit dhanë rekomandime lidhur me nevojën për rritjen e shërbimeve mbështetëse, përmirësimin e infrastrukturës dhe fuqizimin e rolit të prindërve në proceset vendimmarrëse.

Në përfundim, u konstatua se plani përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të kushteve për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe se komentet e pranuar do të integrohen në dokumentin final.

Procesmbajtës:
Ardon Arifaj, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave

